



## Udhërrëfyes për Funkcionalitetin e Gjykatës së Lartë



*“Nuk mjafton të bësh drejtësi,  
por duhet të shihet qartë dhe padyshim se po bëhet drejtësi.”*

*— Kryetari i Gjykatës së Lartë Hewart, 1924*

## **Tabela e Përmbajtjes**

Përmbledhje Ekzekutive	3
Emërimi/Ngritja në Detyrë e Gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë	5
Emërimi/Komandimi i Këshilltarëve Ligjorë në Gjykatën e Lartë	7
Emërimi i Personelit Administrativ Mbështetës në Gjykatën e Lartë	8
Përmirësimi i Metodave dhe Proceseve të Punës	10
Ulja e Numrit të Çështjeve të Prapambetura	12
Rritja e Transparencës dhe e Besimit të Publikut	13
Përmbledhje e Varësive Institucionale	14
Synimet dhe Objektivat për Gjyqtarët në Gjykatën e Lartë	15
Synimet dhe Objektivat për Këshilltarët Ligjorë në Gjykatën e Lartë	16
Synimet dhe Objektivat për Personelin Administrativ Mbështetës në Gjykatën e Lartë	17
Synimet dhe Objektivat për Përmirësimin e Metodave dhe Proceseve të Punës	18
Synimet dhe Objektivat për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura	19
Synimet dhe Objektivat për Rritjen e Transparencës dhe e Besimit të Publikut	20
Falënderime	21

## **Përmbledhje Ekzekutive**

Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Gjykata e Lartë po përballen me një situatë tejte të vështirë sa i përket funksionalitetit të Gjykatës. Të dy institucionet e pranojnë që funksionimi i Gjykatës së Lartë është thelbësor për gjyqësorin në Shqipëri dhe, çka është më e rëndësishme, për qytetarët e Shqipërisë. Aksesin në drejtësi mbetet një përparësi kyçe si për Këshillin, ashtu edhe për Gjykatën.

Ne pranojmë pikat e nxjerra në Përfundimet e Këshillit të Bashkimit Evropian (BE) Nr. 7002/20 të datës 20 mars 2020, ku theksohet se në mënyrë që të vijojë më tej me procesin e integritimit në BE, ndër të tjera, Shqipëria duhet të sigurojë funksionimin e Gjykatës së Lartë.

Gjithashtu njohim Opinionin e Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) me Nr. 978/2020, datë 19 qershor 2020, i cili theksoi se “Është me rëndësi jetike për Shqipërinë që të ripërtërijë sa më shpejt Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë”. Ne e marrim në konsideratë të veçantë ripërtëritjen e Gjykatës së Lartë me qëllim sigurimin e ripërtëritjes së Gjykatës Kushtetuese.

Me qëllim trajtimin e sfidës me të cilën përballemi dhe me qëllim marrjen e hapave të nevojshëm në kuadër të kompetencave të Këshillit dhe Gjykatës, fillimisht ishte e nevojshme të identifikoheshin dhe të arrihej dakordësi e përbashkët se çfarë nënkuptohet me “funksionalitet” në kontekstin e kuadrit ligjor shqiptar. Së bashku, me përkrahjen edhe të partnerëve tanë ndërkombëtarë, kemi arritur në përfundimin se funksionaliteti i Gjykatës së Lartë nënkupton se strukturat e përcaktuara me ligj, si ato gjyqësore edhe administrative, janë të ngritura në atë masë sa t’i lejojnë Gjykatës të trajtojë në shkallë të arsyeshme çështjet e prapambetura dhe ato të reja. Numri i çështjeve të prapambetura në Gjykatë është mbi 35.000 çështje, disa prej të cilave janë në pritje të gjykimit për më shumë se prej 5 vitesh. Kështu që, është me rëndësi jetike për aksesin në drejtësi që ne të sigurojmë funksionalitetin e Gjykatës për t’i mundësuar asaj të trajtojë me efikasitet dhe efektshmëri çështjet e prapambetura dhe të gjitha çështjet e reja që depozitohen.

Përtej kësaj dakordësie të përbashkët, dhe më specifikisht, kjo nënkupton:

- 1)** Gjykata duhet të ketë një numër gjyqtarësh që është i nevojshëm për të garantuar vendimmarrje të vlefshme. Në përputhje me Ligjin Nr. 98/2016 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" (Ligji për Pushtetin Gjyqësor), Gjykata e Lartë gjykon si më poshtë:
  - ✓ Kolegji Civil gjykon në trupa gjyqësore të përbërë nga tre gjyqtarë;
  - ✓ Kolegji Penal gjykon në trupa gjyqësore të përbërë nga tre gjyqtarë për çështjet penale të juridiksionit të përgjithshëm dhe në trupa gjyqësore të përbërë nga pesë gjyqtarë për çështjet penale të gjykatave të posaçme penale;
  - ✓ Kolegji Administrativ gjykon në trupa gjyqësore të përbërë nga tre gjyqtarë për çështjet administrative të përgjithshme dhe me pesë gjyqtarë për gjykimin e akteve normative nënligjore;
- 2)** Gjykata duhet të ketë personel të mjaftueshëm mbështetës, dhe, përveç strukturës tradicionale të administrimit të gjykatës, ligji parashikon dy struktura të reja kryesore mbështetëse, të cilat janë:
  - ✓ Njësia e Shërbimit Ligjor që përbëhet nga këshilltarë ligjorë, në të cilën më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm përbëhet nga magjistratë të komanduar dhe të tjerët këshilltarë ligjorë jo-magjistratë të caktuar nga KLGJ-ja.

- ✓ Qendra e Dokumentacionit, e cila mbështet Gjykatën duke siguruar: analizë të praktikës gjyqësore të të gjitha gjykatave shqiptare dhe gjykatave ndërkombëtare dhe informacion mbi interpretimin e ligjit nga ana e gjykatave.

Mbështetur në dakordësinë tonë kolektive, vlerësojmë se aktualisht Gjykata është në gjendje “funktionaliteti minimal”, dhe synimi ynë i përbashkët është të ndërmarrim hapat e nevojshme që Gjykata të arrijë sa më shpejt “funktionalitet optimal” dhe brenda vitit 2020.

Është me rëndësi kritike që Gjykata të pajiset me burimet e nevojshme njerëzore, përfshirë gjyqtarët dhe personelin shtesë, si dhe burimet e mjaftueshme financiare, me qëllim fillimin e adresimit të kësaj situatë sa më shpejt të jetë e mundur dhe që të jetë e aftë të fillojë trajtimin e qenësishëm të situatës së çështjeve të prapambetura gjatë vitit 2020. Në këtë kontekst, është i nevojshëm një udhërrëfyes që përfshin një sërë planesh veprimi të cilat do të zbatohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Gjykata me synim arritjen e qëllimeve të mëposhtme gjatë vitit 2020:

- ✓ Gjykata arrin një gjendje funksionaliteti që është sa më pranë optimalet të jetë e mundur;
- ✓ Ridhënien e aksesit në drejtësi;
- ✓ Vihen në zbatim metoda më efikase dhe të efektshme të përpunimit të çështjeve;
- ✓ Fillon ulja e konsiderueshme e numrit të çështjeve të prapambetura;
- ✓ Gjykata funksionale ndërmerr veprime të shpejta për të përmbushur detyrimin e saj për zgjedhjen e anëtarëve për në Gjykatën Kushtetuese.

Për këto arsye, kemi hartuar Udhërrëfyesin dhe Planet e Veprimit të përfshira më poshtë, të gjitha në përputhje me Planin Strategjik të Këshillit dhe Gjyqësorit 2019-2020, si dhe me Strategjinë Ndërsëktoriale të Drejtësisë. Veprimtari kyçe, si emërimi dhe/ose ngritja në detyrë e gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë duhet të drejtohen nga Këshilli, ndërsa veprimtaritë që lidhen me analizën edhe vendimmarrjen për çështjet e lëna pezull dhe për metodat e punës duhet të drejtohen nga vetë Gjykata. Ka edhe veprimtari ku kërkohet veprim i përbashkët dhe në bashkëpunim për të cilat duhet të ecim me të njëjtin hap, dhe këto lidhen me punësimin e personelit administrativ mbështetës, përfundimin e burimeve të duhura financiare, përmirësimet e sistemeve aktuale elektronike të menaxhimit të çështjeve dhe marrëdhëniet e mirëpërcaktuara me publikun dhe median për të përmirësuar transparencën dhe për të rritur besimin e publikut.

Ne vlerësojmë dhe mirëpresim mbështetjen e vazhdueshme të partnerëve tanë strategjik, Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës si dhe projekteve EURALIUS V dhe Drejtësi për të Gjithë të USAID-it. Gjithashtu, vlerësojmë komentet dhe sugjerimet e vazhdueshme nga përfaqësues të vendeve anëtare të BE-së dhe të gjitha misionëve diplomatike që vijojnë të na mbështesin në rrugëtimin tonë në kuadër të procesit të reformës në drejtësi.

## Emërimi/Ngritja në Detyrë e Gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë

Me qëllim që Gjykata të bëhet funksionale, procesi i emërimit dhe/ose ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, që tashmë ka nisur, do të trajtohet me hapa të shpejtë nga Këshilli. Plani i veprimit në faqen 15 jep detaje më konkrete për pozicionet e veçanta dhe statusin e tyre, dhe hapat më poshtë janë marrë/do të merren në konsideratë me prioritet të lartë:

- I. Përfundimi i procesit të emërimit të gjyqtarit të katërt nga radhët e jo magjistratëve. Do të ndërmerren menjëherë hapa për të adresuar të gjitha pengesat, dhe Këshilli parashikon përfundimin e këtij procesi jo më vonë se brenda muajit shtator 2020.
- II. Kemi përcaktuar afate të arsyeshme brenda të cilave mund të përfundojnë procedurat e nisura tashmë për ngritjen në detyrë për gjashtë pozicionet që lidhen me fushën civile dhe administrative, të cilat mund t'i gjeni të reflektuara në planin e veprimit në faqen 15.
- III. Kemi shpallur edhe katër pozicione në tjera në fushën penale dhe një në atë administrative, në afate të arsyeshme, por të shpejta. Periudha e aplikimit për këto pozicione mbyllet më 30 korrik 2020.
- IV. Do të analizojmë nevojat e Gjykatës lidhur me të gjitha pozicionet e mbetura gjyqësore duke theksuar ato fusha të së drejtës me përqindjen më të madhe të numrit të çështjeve të prapambetura në Gjykatë, ku aktualisht kjo ndarje çështjesh vlerësohet të jetë 51% civile, 32% administrative dhe 17% penale. Vendimet për shpalljen e këtyre tre pozicioneve shtesë do të merren brenda periudhës shtator-tetor 2020.

Suksesi jonë varet dhe/ose rrezikohet, ndër të tjera, nga sa më poshtë:

- Ndërprerjet e vazhdueshme ose të herëpashershme të proceseve të punës si pasojë e pandemisë shkaktuar nga COVID-19;
- Mungesa e kandidatëve të kualifikuar dhe/ose të interesuar. Vihet re një hezitim nga ana e gjyqtarëve të pavetuar për të aplikuar për mundësitë e ngritjes në detyrë.

KLJG po merr në konsideratë një anketim të gjyqtarëve me qëllim përcaktimin e faktorëve nxitës dhe pengues që përkatësisht inkurajojnë dhe shkurajojnë gjyqtarët të kandidojnë për ngritje në detyrë në rrethanat aktuale dhe të ardhshme. Kjo do të ndihmonte KLJG-në të kuptonte se si duhet të veprojnë për rritjen e numrit të gjyqtarëve të gatshëm për të ndërmarrë përgjegjësitë shtesë që janë pjesë e çdo ngritjeje në detyrë.

- Procesi i vetingut (varësi e jashtme) – arritja e një marrëveshjeje ndër-institucionale mbi nevojat për prioritizimin e kandidatëve për ngritjen në detyrë. Kohëzgjatja e proceseve të vetingut paraqet një rrezik për procesin e KLJG-së për ngritjen në detyrë. Jemi të hapur për marrëveshje institucionale, si zyrtare ashtu edhe jo formale, me organet e vetingut dhe agjencitë mbështetëse për të lejuar që kandidatët për ngritjen në detyrë të kalojnë në krye

të listës së prioritetit dhe të realizohet procedura e vlerësimit të tyre kalimtar brenda një afati 3 mujor.

Këshilli ka parashikuar një mekanizëm zhblllokues që lejon gjyqtarët e pavetuar të ngrihen në detyrë, përmes një procesi të brendshëm verifikimi të kryer nga vetë Këshilli kur organet e vetingut nuk e finalizojnë vetingun e kandidatëve brenda një afati tre mujor. Megjithatë, kjo zgjidhje sjell si pasojë rrezikun e konsiderueshëm për të cenuar reputacionin e Këshillit dhe legjitimitetin e Gjykatës, nëse kandidati ngrihet në detyrë dhe më pas shkarkohet nga KPK apo Kolegji i Posaçëm i Apelit. Nga ana tjetër, parimet e qasjes në drejtësi dhe vijimësisë së funksionimit të gjykatës e detyrojnë KLGJ-në të vijojë procesin e ngritjeve në detyrë, duke ofruar mundësi të barabarta për ngritje në detyrë.

Vetingu merr një rëndësi shumë të madhe kur bëhen kërkesa nga ana e gjyqtarëve të pavetuar për ngritjen në detyrë. Në këtë rast, KLGJ-ja është e kufizuar se si mund ta çojë përpara procesin e ngritjes në detyrë. Për shembull, nëse për një pozicion të vetëm ngritje në detyrë aplikojnë pesë gjyqtarë dhe njëri prej tyre nuk është vetuar ende, Këshilli duhet ta ndalojë procesin e rekrutimit për të gjithë kandidatët deri në momentin që KPK-ja merr një vendim mbi vlerësimin e tij kalimtar. Në rrethanat aktuale, njëri prej gjyqtarëve të pavetuar, i cili ka aplikuar për në Gjykatë të Lartë, është përzgjedhur për veting prej më shumë se një viti dhe ende nuk ka një vendim për datën përfundimtare. Nëse kandidati nuk e tërheq aplikimin ose procesi i vetingut përfundon, ky proces i ngritjes në detyrë nuk ecën përpara.

- Kandidatët për ngritje në detyrë kanë të drejtën e ankimit kundër vendimeve të KLGJ lidhur me vlerësimin e tyre etik dhe profesional dhe të renditjes të marra në kuadër të procesit të ngritjes në detyrë. KLGJ duhet të ndalë procesin e ngritjes në detyrë gjatë procesit të shqyrtimit gjyqësor të ankimit. Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit merr formë të prerë dhe nuk i nënshtrohet shqyrtimeve të mëtejshme gjyqësore.

## **Emërimi/Komandimi i Këshilltarëve Ligjorë në Gjykatën e Lartë**

Këshilltarët ligjorë janë një mekanizëm i drejtpërdrejtë dhe kritik mbështetjeje për gjyqtarët dhe për sigurimin e proceseve të efektshme dhe të bashkërenduara të vendimmarrjes. Kështu, ne angazhohemi të ndërmerim hapat e mëposhtëm si përparësi në këtë drejtim, ndërsa një planifikim më i detajuar është paraqitur në faqen 16:

- I. Miratimi i rregullave të brendshme standarde të nevojshme për Gjykatën e Lartë, në mënyrë që Gjykata të mund të miratojë rregulla të mëtejshme të detajuara sipas përcaktimeve ligjore, duke lejuar kështu arritjen e një numri të përshtatshëm këshilltarësh ligjorë në Gjykatë;
- II. Sigurimi i të gjitha akteve nënligjore që të jenë gati për të lejuar emërimin e menjëhershëm të katër këshilltarëve ligjorë që do të diplomohen nga Shkolla e Magjistraturës (SHM) në gusht 2020;
- III. Hapja e procedurave të brendshme të komandimit për numrin e përshtatshëm të ndihmësve magjistratëve.

Po ashtu si edhe në rastin e emërimit/ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, sukcesi jonë varet nga procesi i rekrutimit për këshilltarët ligjorë jo-magjistratë dhe ata të komanduar.

### **Procesi për këshilltarët ligjorë jo-magjistratë varet dhe rrezikohet nga:**

- Vonesat në procesin e sigurimit të dokumentacionit të kërkuar nga institucionet e tjera që mund të ngadalësojnë dhe vonojnë verifikimin e të diplomuarve nga Shkolla e Magjistraturës, dhe rrjedhimisht, të vonojnë emërimin e tyre të përhershëm;

### **Procesi për këshilltarët ligjorë të komanduar varet dhe rrezikohet nga:**

- Mungesa e interesit, dhe rrjedhimisht, numri i pamjaftueshëm i kandidatëve nga radhët e gjyqtarëve.

## **Emërimi i Personelit Administrativ Mbështetës në Gjykatën e Lartë**

Siç u tha më lart, funksionaliteti i Gjykatës nuk është vetëm çështje e numrit të gjyqtarëve të emëruar, por edhe çështje e organizimit të përgjithshëm dhe personelit të Gjykatës, përfshirë këtu edhe strukturat mbështetëse. Është e rëndësishme të theksohet se të dy proceset, ai i emërimit/ngritjes në detyrë të gjyqtarëve dhe ai i ngritjes së strukturave administrative mbështetëse, do të ndërmerren në të njëjtën kohë, me qëllim sigurimin e mekanizmave të mjaftueshëm mbështetës për numrin përkatës të gjyqtarëve në secilën fazë.

Në këtë pikëpamje, angazhohemi të marrim hapat më poshtë, ndërkohë që planifikimi më i hollësishëm paraqitet më poshtë në faqen 17:

- I. Miratimi sa më parë i rregullave standarde për procedurat e brendshme të Gjykatës së Lartë (Këshilli i Lartë Gjyqësor);
- II. Miratimi i menjëhershëm i akteve nënligjore të nevojshme për shpalljen e thirrjeve për personel administrativ (Këshilli i Lartë Gjyqësor);
- III. Ngritja e Qendrës së Dokumentacionit në Gjykatë dhe sigurimi i burimeve financiare të nevojshme për rekrutimin e personelit të kualifikuar (Gjykata e Lartë);
- IV. Sigurimi i burimeve financiare të përshtatshme për vitin 2020 në mënyrë që Gjykata e Lartë të rekrutojë dhe të plotësojë vendet vakante në administrimin e gjykatës; rekrutimi i sekretareve gjyqësore për të mbështetur përpunimin më të madh të vendimeve gjyqësore; dhe sigurimi i burimeve financiare të përshtatshme për vijimin dhe/ose plotësimin e të gjitha pozicioneve në buxhetin e vitit 2021 (Gjykata e Lartë dhe KLGJ) .
- V. Gjykata e Lartë nuk ka një Kancelar të përhershëm dhe duhet ta zgjidhë këtë çështje duke punësuar, përmes transferimit, ngritjes në detyrë apo emërimit, një kandidat të kualifikuar për Kancelar. Kjo është një nevojë kritike për drejtimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të Gjykatës. KLGJ do të dialogojë me Gjykatat dhe Shkollën e Magjistraturës për përcaktimin e numrit të vendeve për kandidatë për Kancelar, me qëllim që SHM të vërë në zbatim proceset e nevojshme për fillimin e Programit 3 mujor të Administrimit të Gjykatës për Kancelarët e ardhshëm.

Lidhur me këtë dhe me qëllim mbështetjen e veprimit të mësipërm, KLGJ-ja do t'i japë përparësi përfundimit të verifikimit dhe konfirmimit të Kancelarëve në detyrë, gjatë 4 muajve në vijim.



Sa i përket Personelit Administrativ të Gjykatës së Lartë, suksemi jonë varet nga sa më poshtë:

- Ndërprerjet e vazhdueshme ose të herëpashershme të proceseve të punës si pasojë e pandemisë COVID-19;
- Ndryshimet në buxhetin e vitit 2020 mund të jenë të vështira në këtë moment të vitit – mund të jetë e nevojshme rakordimi i buxheteve aktuale;
- Buxhetet për vitin 2021, që janë përtej alokimeve të 2020-s, duhet të miratohen nga Ministria e Financave dhe Kuvendi i Shqipërisë. Do të jetë e nevojshme vendosja e dialogut në funksion të marrëdhënieve profesionale dhe argumentimit të duhur të shtesave të propozuara në buxhet;
- Hapësira e disponueshme brenda Gjykatës së Lartë nuk është e mjaftueshme. Nevoja për të mundësuar distancimin social lidhur me COVID-19 mund të vështirësojë fillimin e punës për stafin shtesë, por që është shumë i domosdoshëm.
- Mungesa e një kancelari të përhershëm, si anëtar kyç i Këshillit të Gjykatës dhe drejtues i stafit administrativ të Gjykatës, ndikon në kapacitetet e gjykatës për të sjellë ndryshimin në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Proceset e nevojshme për të plotësuar këtë pozicion zgjasin rreth 4 deri 5 muaj.

## Përmirësimi i Metodave dhe Proceseve të Punës

Metodat manuale dhe elektronike të punës së Gjykatës nuk mbështesin përpunimin efikas dhe të efektshëm të çështjeve. Me qëllim përmirësimin e situatës, kemi ndërmarrë tashmë disa hapa për të dy rastet. Detajet e hapave aktualë dhe të planifikuar të veprimit janë paraqitur në faqen 18, ndërsa një përmbledhje e problematikave që hasim dhe hapave fillestarë për përmirësim jepet më poshtë.

Sa i përket proceseve manuale të punës, po punojmë me projektin partner Drejtësi për të Gjithë të USAID-it për të ndërmarrë një hartëzim gjithëpërfshirës të proceseve të punës. Kemi përfunduar hartëzimin e proceseve të punës “siç janë”, çka do të na lejojë të fillojmë rihartëzimin për procese të përmirësuara më efikase “si do të jenë”, si për ato manuale ashtu edhe elektronike. Në këtë kuadër, kemi identifikuar tashmë nevojën për të:

- I. Përmirësuar sistemet **manuale** të menaxhimit të çështjeve duke optimizuar përdorimin e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjes, aty ku është e mundur, dhe/ose duke i bërë sa më efikase proceset e nevojshme manuale;
- II. Miratuar rregulla më të detajuara të brendshme të Gjykatës, siç e parashikon ligji, pas miratimit të rregullores së brendshme standard nga KLGJ-ja për Gjykatën e Lartë;
- III. Caktuar objektiva për performancën e gjykatës, gjyqtarëve, këshilltarëve ligjorë dhe gjithë personelit tjetër në mbështetje të uljes efikase të numrit të çështjeve të prapambetura dhe parandalimit të krijimit të çështjeve të tjera të prapambetura;
- IV. Hartuar dhe dorëzuar në Ministrinë e Drejtësisë të ndryshimeve ligjore për Kodet e Procedurës Administrative, Civile dhe Penale, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përbërjes dhe kompetencave të kolegjeve, duke pranuar ndryshimin në rolin e Gjykatës në kuadër të reformës në drejtësi.<sup>1</sup>

Sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve (ICMIS) që përdoret nga Gjykata paraqet një sërë mangësish, që përfshijnë, por nuk kufizohen në sa vijon:

- I. ICMIS nuk ofron informacion të mjaftueshëm që gjyqtarët dhe këshilltarët ligjorë të vlerësojnë dhe kategorizojnë çështjet e reja të depozituara;
- II. ICMIS nuk siguron informacion të mjaftueshëm për analizën statistikore të ngarkesës me çështje duke krijuar kështu nevojën që Zyra e Regjistrimit të shpenzojë kohë shtesë për mbledhjen manuale të këtyre të dhënave;
- III. ICMIS nuk u lejon gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë të kenë akses në versionet elektronike të vendimeve të gjykatave më të ulëta, duke bërë që ata të shpenzojnë kohë të konsiderueshme për hedhjen sërish të këtyre vendimeve në vendimet e tyre.

---

<sup>1</sup> Roli i ndryshuar i Gjykatës së Lartë nga një gjykatë e nivelit të tretë në gjykatë kasacioni duhet të hapë diskutimin rreth: përbërjes së kolegjeve me tre gjyqtarë për të gjykuar të gjithë rekursat, ndërkohë që krijohet praktika uniforme gjyqësore që kërkon kolegje prej 5 gjyqtarësh. Filtrimi i çështjeve për pranueshmëri nga një gjyqtar i vetëm do ta bënte Gjykatën akoma dhe më efikase, dhe do të kishte rezultate të menjëhershme në uljen e numrit të çështjeve të prapambetura.

- IV. ICMIS kërkon që të ndërmerren hapa që kërkojnë kohë lidhur me hedhjen në sistem të vendimeve gjyqësore dhe mendimet e pakicës;
- V. ICMIS nuk ofron një bazë të dhënash që bën të mundur kërkimin e efektshëm të praktikës aktuale gjyqësore të Gjykatës së Lartë, gjë që e bën kërkimin ligjor të marrë më shumë kohë dhe punë intensive.

Ndërkohë që krijimi dhe zbatimi i një sistemi të përmirësuar elektronik të menaxhimit të çështjeve për të gjithë sistemin gjyqësor aktualisht nuk mund të arrihet, ne po punojmë në mënyrë aktive me Projektin Drejtësi për të Gjithë të USAID-it dhe me EURALIUS V për adresimin e problematikave të ICMIS në Gjykatën e Lartë. Presim të kemi burime alternative të ndërmjetme (EURALIUS do të vërë në dispozicion një qendër të dhënash (*data warehouse*) të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta), si dhe përmirësime të ICMIS-it (USAID ka siguruar “rregullime të shpejta”) përpara fundit të vitit 2020.

Suksesi jonë varet dhe rrezikohet nga:

- Ndërprerjet e vazhdueshme ose të herëpashershme ose mbylljet e Gjykatës si pasojë e pandemisë COVID-19;
- Qëndrueshmëria e sistemit ICMIS të Gjykatës së Lartë. Sistemi nuk është mbajtur apo dokumentuar mirë, dhe ndërhyrjet duhen realizuar me shumë kujdes;
- Mungesa e bashkëpunimit në kohë dhe/ose miratimi i ndryshimeve në kodet procedurale, mund të ndikojnë te shpejtësia dhe efektshmëria e zbatimit të masave efikase.

## Ulja e Numrit të Çështjeve të Prapambetura

Dihet fare mirë që numri i çështjeve të prapambetura në Gjykatë është tejet i lartë. Numri aktual i çështjeve të prapambetura mund të paraqitet si më poshtë:

Viti	Administrative	Civile	Penale	Total
2010	0	2	0	2
2011	0	7	0	7
2012	9	18	0	27
2013	78	104	1	183
2014	172	1107	3	1282
2015	1240	3322	10	4572
2016	1809	3757	1141	6707
2017	3402	3543	1287	8232
2018	2825	3156	1669	7650
2019	2204	2463	968	5635
2020	532	591	316	1439 <sup>2</sup>
<b>Total</b>	<b>12271</b>	<b>18070</b>	<b>5095</b>	<b>35736</b>

Me qëllim uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, kemi marrë tashmë disa hapa konkretë, që përfshijnë sa më poshtë, ndërkohë që veprimet e planifikuara për të ardhmen detajohen në planin e veprimit në faqet 18-19:

- I. Krijimi i Komisionit të Posaçëm për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura dhe Përmirësimin e Efektshmërisë në Gjykatën e Lartë;
- II. Nënshkrimi i MM-së për zbatimin e nismave kyçe për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura me Projektin Drejtësi për të Gjithë të USAID-it;
- III. KLGJ-ja, përmes Komisionit të saj Posaçëm, do të fillojë procesin e rishikimit të legjislacionit përkatës (ligjet materiale dhe procedurale) për ndryshimet që e bëjnë më efikase Gjykatën e Lartë. Kjo do të realizohet përmes një procesi të qëndrueshëm të konsultimeve me gjyqtarët.
- IV. Zbatimi i punës së Ekipeve për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura në mbështetje të identifikimit dhe përpunimit efikas të çështjeve të papranueshme për të zbuluar më mirë ngarkesën reale të Gjykatës;
- V. Puna së bashku me EURALIUS dhe Projektin Drejtësi për të Gjithë të USAID-it për identifikimin dhe zbatimin e modeleve të praktikës më të mirë të menaxhimit të çështjeve aktive;

Suksesi me uljen e numrit të çështjeve të prapambetura varet dhe/ose rrezikohet nga:

- Mbylljet e vazhdueshme ose të herëpashershme të gjykatës si pasojë e pandemisë COVID-19;
- Numri i gjyqtarëve në detyrë, siç paraqitet në tabelën në faqen 15, nuk është i mjaftueshëm (7 gjyqtarë të tjerë deri në fillim të dhjetorit 2020);

<sup>2</sup> Këto shifra paraqesin çështjet e reja të depozituara brenda 2020-s dhe jepen vetëm si referencë për numrin e përgjithshëm të çështjeve. Këto çështje nuk konsiderohen si të prapambetura.

## **Rritja e Transparencës dhe e Besimit të Publikut**

Numri i konsiderueshëm i çështjeve të prapambetura, shoqëruar me një periudhë të gjatë jofunksionaliteti, ka çuar në një rënie të madhe të besimit të publikut në Gjykatën e Lartë, si shkalla më e lartë e sistemit gjyqësor. Këshilli dhe Gjykata pranojnë nevojën për të vepruar në një mënyrë të tillë që drejtësia jo vetëm të jepet, por edhe të duket që jepet.

Zhvillimet e fundit në Gjykatë tregojnë që ka ndodhur një ndryshim, po përfundohen më shumë çështje, dhe gjyqtarët e rinj po përdorin mënyra më krijuese dhe efikase pune. Këto dhe zhvillime të tjera të planifikuara duhet t'i përcillen publikut në mënyrë të kuptueshme me qëllim arritjen e besimit te Gjykata.

Ne po bashkëpunojmë me Projektin Drejtësi për të Gjithë të USAID-it për të përgatitur një fushatë për ndërgjegjësimin e publikut, e cila do të jetë gati brenda tetorit 2020 dhe do të përqendrohet në disa prej temave të renditura më poshtë. Një plan më të hollësishëm pune mund ta gjeni në faqen 20.

Temat:

- Roli i ri i Gjykatës së Lartë. Si e ndryshoi reforma Gjykatën e Lartë?
- Si mund të ndërveprojë më mirë publiku me Gjykatën e Lartë?
- Si po e ndryshon Gjykata e re mënyrën e të punuarit? Çfarë nënkupton kjo për avokatët dhe palët me vetëpërfaqësim?

## **Përmbledhje e Varësive Institucionale**

Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Gjykata e Lartë kuptojnë dhe pranojnë rolet përkatëse në kuadrin e një gjyqësori të pavarur, si një nga tre pushtetet e qeverisjes, për të drejtuar dhe administruar në mënyrë proaktive ndryshimet e nevojshme që do t'i lejojnë Gjykatës së Lartë të arrijë nivelin më të përshtatshëm të funksionalitetit.

Megjithatë, duhet të theksojmë se, në shumë fusha, sukcesi jonë varet nga vullneti i mirë dhe efektshmëria e institucioneve të tjera të pavarura dhe pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ.

Ne kërkojmë partneritetin dhe bashkëpunimin me institucionet e renditura më poshtë dhe me respekt kërkojmë mbështetjen dhe advokimin e partnerëve tanë ndërkombëtarë për arritjen e qëllimeve tona në 4 deri në 6 muajt e ardhshëm dhe në periudha më afatgjata.

### **Institucionet që ndikojnë në suksesin e KLGJ-së**

- 1) Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK – Shkalla e parë e vetingut)
- 2) Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA – Shkalla e dytë e vetingut)
- 3) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI)
- 4) Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH)
- 5) Shërbimi Informativ Shtetëror Shqiptar (ShISh)
- 6) Ministria e Drejtësisë – Drejtoria e Kodifikimit
- 7) Komisioni Parlamentar i Ligjeve pranë Kuvendit
- 8) Ministria e Financës
- 9) Shkolla e Magjistraturës (SHM)

## Synimet dhe Objektivat për Gjyqtarët në Gjykatën e Lartë

	Qëllimi & Objektivat	Treguesi i Suksesit	Veprimtaritë Kyçe (Si)				Afati	Drejtuesi (Kush)	Statusi	Komente
PLANI STRATEGJIK I GJYQËSORIT	1.1 Bërja funksionale e Gjykatës së Lartë si prioritet emergjent, duke marrë masat e nevojshme për plotësimin e vendeve vakante sa më shpejt.	Treguesi për Mbështetjen Buxhetore të SNSD - 5 gjyqtarë të emëruar deri më 31 dhjetor 2019 dhe 7 gjyqtarë të tjerë të emëruar deri më 31 dhjetor 2020	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Shpallja e vakancave;</li> <li>➤ Vlerësimi i kandidatëve;</li> <li>➤ Propozimi i gjyqtarëve kandidatë për pozicione në Gjykatën e Lartë të Presidentit të Republikës duke përdorur kriteret për përzgjedhjen sipas përcaktimeve të Ligjit "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve";</li> <li>➤ Vlerësim i nevojës lidhur me vakancat.</li> </ul>				Prill 2019 deri në dhjetor 2020	Komisionet e Zhvillimit të Karrierës dhe Etikës dhe i Vlerësimit Profesional dhe Mbledhja Plenare	Në proces	Në pajtim me Planin e Veprimit të SNSD Shkurt 2019
		<b>Pikësynimi i Korrigjuar 10 gjyqtarë gjithsej jo më vonë se 5 dhjetor 2020</b>								
		<b>Statusi</b>	<b>Afatet dhe Hapat e Parashikuar për Përfundim</b>							
1	<b>Pozicioni A</b>	Plotësuar – Penale	Irir Panda							
2	<b>Pozicioni B</b>	Plotësuar – Civile	Ervin Pupe							
3	<b>Pozicioni C</b>	Plotësuar - Admin	Sokol Sadushi							
		<b>Vakancat</b>	<b>Hapat thirrja për aplikime për plotësimin e vakancave</b>	<b>Përfundon periudha e thirrjes për aplikime</b>	<b>KLJG vendos të hapë procedurën e verifikimit dhe cakton relatorin</b>	<b>KLJG vendos mbi plotësimin e kriterëve formale</b>	<b>KLJG përfundon vendimin mbi kualifikimin</b>	<b>KLJG përfundon vlerësimin etik dhe profesional të kandidatëve<sup>3</sup></b>	<b>KLJG bën renditjen dhe vendos propozimet për emërim të kandidatëve për paraqitje Presidentit</b>	<b>KLJG i dërgon listat Presidentit dhe i shpall publikisht propozimet</b>
4	<b>Pozicioni D</b>	Shpallur – Civile					shtator 2020	30 shtator 2020		
5	<b>Pozicioni E</b>	Shpallur – Civile**					tetor 2020	**Në pritje të vendimeve të KPK-së për kandidatët e pavetuar dhe miratimit të Ligjit për Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit <sup>4</sup>		
6	<b>Pozicioni F</b>	Shpallur – Civile**					tetor 2020			
7	<b>Pozicioni G</b>	Shpallur – Admin**					tetor 2020			
8	<b>Pozicioni H</b>	Shpallur – Admin					tetor 2020	Në pritje të verifikimit nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit		
9	<b>Pozicioni I</b>	Shpallur – Civile		30 korrik 2020	shtator 2020	nëntor 2020	nëntor 2020	30 nëntor 2020	1 dhjetor 2020	
10	<b>Pozicioni J</b>	Shpallur – Admin		30 korrik 2020	shtator 2020	nëntor 2020	nëntor 2020	30 nëntor 2020	1 dhjetor 2020	
11	<b>Pozicioni K</b>	Shpallur – Penale		30 korrik 2020	shtator 2020	nëntor 2020	nëntor 2020	30 nëntor 2020	1 dhjetor 2020	
12	<b>Pozicioni L</b>	Shpallur – Penale		30 korrik 2020	shtator 2020	nëntor 2020	nëntor 2020	30 nëntor 2020	1 dhjetor 2020	
13	<b>Pozicioni M</b>	Shpallur – Penale		30 korrik 2020	shtator 2020	nëntor 2020	nëntor 2020	30 nëntor 2020	1 dhjetor 2020	
14	<b>Pozicioni N</b>	Shpallur – Penale		30 korrik 2020	shtator 2020	nëntor 2020	nëntor 2020	30 nëntor 2020	1 dhjetor 2020	
15	<b>Pozicioni O</b>	Shpallur – Admin		30 korrik 2020	shtator 2020	nëntor 2020	nëntor 2020	30 nëntor 2020	1 dhjetor 2020	
16	<b>Pozicioni P</b>	Për t'u përcaktuar	Shpallja pezull në pritje të vendimmarrjes në shtator - tetor duke u mbështetur në ngarkesën e punës së Gjykatës dhe të dhënat për një vit të përpunimit të çështjeve							
17	<b>Pozicioni Q</b>	Për t'u përcaktuar								
18	<b>Pozicioni R</b>	Për t'u përcaktuar								
19	<b>Pozicioni S</b>	Plotësuar	Medi Bici – Anëtar i KLJG-së (Mandati në Gjykatën e Lartë pezulluar gjatë periudhës së anëtarësisë në KLJG)							

<sup>3</sup> KLJG parashikon se do të duhet të kualifikojë dhe vlerësojë deri në 30 kandidatë në periudhën korrik deri më 30 nëntor 2020, që është data e parashikuar e renditjes

<sup>4</sup>Më 7 maj 2020, KLJG i dërgoi kërkesë KPK duke i kërkuar të prioritzonte vetingun e dy gjyqtarëve, kandidatë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë. Njëri nga gjyqtarët ka mbi një vit që është në proces vetingu, dhe KLJG priste që KPK të ishte në gjendje të përgjigjej me një vendim të përfunduar brenda tre muajve nga data 7 maj e shkresës. Deri më sot, KLJG nuk ka marrë asnjë përgjigje nga KPK dhe nuk sheh asnjë progres në procesin e vetingut të dy kandidatëve. Njëri nga kandidatët ka aplikuar për dy pozicione, duke bërë që rrjedhimisht të pezullohen të dyja. Për 6 kandidatë të tjerë vendimmarrja për kualifikimin varet nga verifikimi prej Autoritetit për Informim mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), për të cilin afati ligjor (sipas ligjit 45/2015) ka përfunduar më datë 31.03.2020, ndërsa ligji është hequr nga kalendari i punimeve të muajit korrik, duke e shtyrë miratimin, pa u përcaktuar një afat i ri.

## Synimet dhe Objektivat për Këshilltarët Ligjorë në Gjykatën e Lartë

	Qëllimi & Objektivat	Treguesi i Suksesit	Veprimtaritë Kyçe (Si)	Afati	Drejtuesi (Kush)	Statusi	Komente				
PLANI STRATEGJIK I GJYQËSORIT	1.2 Rikthimi i shpejtë i aftësisë së Gjykatës së Lartë për të funksionuar, duke trajtuar nevojat e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore	<u>Miratohet dhe zbatohet plani i rekrutimit</u> i Gjykatës së Lartë dhe është kryer një vlerësim i TI-së	➤ Hartohet një plan për punësimin e Këshilltarëve Ligjorë të mjaftueshëm për të mbështetur edhe Gjykatën dhe KED-në	Maj deri dhjetor 2020	KLJ dhe Këshilli i Gjykatës së Lartë	Në proces	Në pajtim me Planin e Veprimit të SNSD Shkurt 2019 Nën - Objektivi 5/2, Seksionet 3 & 5				
<b>Afatet dhe Hapat e Parashikuar për Përfundim – Këshilltarët Ligjorë të Komanduar*</b>											
	Pozicionet vakante dhe ato të nevojshme shtesë	Nr. i vendeve të nevojshme	Statusi	Gjykata e Lartë dërgon kërkesën në KLJ	KLJ pranon aplikimet	KLJ shqyrton dhe vendos për kandidatët	KLJ dërgon listën e kandidatëve në Gjykatën e Lartë	Gjykata e Lartë vlerëson kandidatët dhe kërkon komandimin	KLJ merr vendim për komandimin	Këshilltarët e rinj ligjorë fillojnë detyrën	
1	Këshilltarët Ligjorë të Komanduar (Ndhmës Magjistratë)	10 në total nevojiten deri në dhjetor 2020	Aktualisht 4 në detyrë Nevojiten 6	Korrik 2020	24 korrik – 4 shtator 2020	Shtator 2020			Shtator 2020	Tetor 2020	
<b>Afatet dhe Hapat e Parashikuar për Përfundim – Këshilltarët Ligjorë të Caktuar*</b>											
	Pozicionet vakante dhe ato të nevojshme shtesë	Nr. i vendeve të nevojshme	Statusi	4 kandidatë diplomohen nga Shkolla e Magjistraturës	KLJ miraton aktet nënligjore për verifikimin	KLJ cakton përkohësisht 4 kandidatë	KLJ kryen verifikimin e këshilltarëve ligjorë të caktuar përkohësisht			KLJ vendos për verifikimin e këshilltarëve ligjorë	KLJ emëron këshilltarët ligjorë me status të përhershëm
2	Këshilltarët Ligjorë të Emëruar (Të diplomuar nga SHM korrik/gusht 2020)	10 në total nevojiten deri në dhjetor 2020	Aktualisht 6 në detyrë 4 për t'u diplomuar nga SHM në gusht 2020	Gusht 2020	15 shtator 2020	Shtator 2020	Shtator deri në dhjetor 2020			Janar 2021	Janar 2021

\***Komente:** Për të dy kategoritë, numri i këshilltarëve ligjorë përcaktohet nga numri i gjyqtarëve të prezumuar në detyrë nga dhjetori 2020. Aktualisht, Gjykata aplikon raportin 2 me 1 të këshilltarëve ligjorë me gjyqtarët. Ligji kërkon një ekuilibër midis dy kategorive të këshilltarëve ligjorë.



**Synimet dhe Objektivat për Personelin Administrativ Mbështetës në Gjykatën e Lartë**

	Qëllimi & Objektivat	Treguesi i Suksesit	Veprimtaritë Kyçe (Si)	Afati	Drejtuesi (Kush)	Statusi	Komente
PLANI STRATEGJIK I GJYQËSORIT	<b>1.2 Rikthimi i shpejtë i aftësisë së Gjykatës së Lartë për të funksionuar, duke trajtuar nevojat e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore.</b>	<b>Miratohet dhe zbatohet plani i rekrutimit</b> i Gjykatës së Lartë dhe është kryer një vlerësim i TI-së	➤ Hartohet një plan për punësimin e Këshilltarëve Ligjorë të mjaftueshëm për të mbështetur Gjykatën dhe KED.	Maj deri dhjetor 2020	KLJG dhe Këshilli i Gjykatës së Lartë	Në proces	Në pajtim me Planin e Veprimit të SNSD Shkurt 2019 Nën - Objektivi 5/2, Seksionet 3 & 5

**Afatet dhe Hapat e Parashikuar për Përfundim – Kancelar**

Pozicioni i kërkuar	Nr. i vendeve të nevojshme	Statusi	KLJG dhe SHM bien dakord që të hapin thirrjen për grupin e parë të kancelarëve të rinj	SHM hap thirrjen dhe kryen procesin e plotë të pranimit të 5-10 kandidatëve për kancelarë	Fillon Programi i Parë i PAGJ-së	KLJG kryen verifikimin e kancelarëve në detyrë	SHM përfundon testimin e kancelarëve në detyrë të verifikuar	Konfirmohet statusi i kancelarëve në detyrë që kalojnë provimin e SHM-së	Kandidatët për Kancelarë përfundojnë PAGJ-në dhe testimin	Konfirmohen kandidatët për kancelarë
1 Kancelar	1	Në pritje	Shtator 2020	Shtator – Tetor 2020	Nëntor 2020	Shtator – Dhjetor 2020	Janar 2020		Shkurt 2021	Shkurt 2021

**Afatet dhe Hapat e Parashikuar për Përfundim – Personeli Administrativ Mbështetës**

Pozicionet vakante dhe ato të nevojshme shtesë	Nr. i vendeve të nevojshme	Statusi	KLJG miraton aktet nënligjore për Nëpunësin Civil Gjyqësor	KLJG miraton rregullat e brendshme standarde për Gjykatën e Lartë	Gjykata e Lartë harton “rregulla më të detajuara” paraprake për veprimtarinë e gjykatës- përfshirë organigramën*	Gjykata e Lartë rialokon buxhetin e 2020 për të punësuar personel administrativ mbështetës	Ngrihet Qendra e Dokumentacionit	Hapet rekrutimi për stafin mbështetës	Merret vendim për përzgjedhjen dhe punësimin	Stafi i ri fillon punën
1 Kërkues Ligjorë në Qendrën e Dokumentacionit	10	Nuk është autorizuar/buxhetuar Duhet rialokuar buxheti 2020 për të punësuar nga kursimet e rrogave	Shtator 2020	Shtator 2020**	Korrik – Tetor*	Shtator 2020	Tetor 2020	Tetor 2020	Nëntor – Dhjetor 2020	
2 Sekretare Gjyqësore Mbështetëse në Seancë	5	Duhet rialokuar buxheti 2020 për të punësuar nga kursimet e rrogave				Shtator – Tetor 2020	Nuk zbatohet	Tetor 2020	Nëntor – Dhjetor 2020	
3 Sekretare Gjyqësore Mbështetëse në Zyrën e Regjistrimit	5	Duhet rialokuar buxheti 2020 për të punësuar nga kursimet e rrogave								

**Komente:** \*Gjykata ka ngritur një grup pune për të rishikuar dhe rekomanduar ndryshimet në strukturën e saj. Grupi do të punojë nga korriku deri sa KLJG të miratojë rregullat e brendshme standarde për organigramën dhe veprimtaritë e saj. Gjykata dhe KLJG do të punojnë për të garantuar që nevojat e parashikuara të përfshihen në buxhetin e 2021, ndërkohë që për 2020 Gjykata do të rialokojë kursimet e buxhetit për të punësuar stafin e nevojitur administrativ.

Grupi i punës nuk e ka parë ende draftin e rregullave dhe nuk mund të parashikojë në mënyrë të arsyeshme kohën që nevojitet për rishikimin e tij. Partnerët ndërkombëtarë bien dakord të punojnë mbi draftin gjatë muajve korrik dhe gusht për të garantuar një draft të mirë strukturuar dhe të lehtë për t'u rishikuar nga KLJG-ja.

**Synimet dhe Objektivat për Përmirësimin e Metodave dhe Proceseve të Punës**

	Qëllimi & Objektivat	Treguesi i Suksesit	Veprimtaritë Kyçe (Si)	Afati	Drejtuesi (Kush)	Statusi	Komente
PLANI STRATEGJIK I GJYQËSORIT	3.3. Sigurohet mirëfunksionimi i gjykatave përmes miratimit të rregullave të unifikuara për administrimin e gjykatave	80% e gjykatave kanë zbatuar standardet e reja të administrimit të gjykatës	<ul style="list-style-type: none"> <li>Miratimi i rregullave standarde të brendshme për funksionimin e gjykatave</li> <li>Monitorimi dhe administrimi i ngarkesës së gjyqtarëve dhe gjykatave me çështje, kohëzgjatjes së procedimeve dhe aspekteve të tjera të administrimit gjyqësor, me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave, ose uljen e ngarkesës së gjyqtarëve me çështje dhe ngarkesës së punës së nëpunësve civilë gjyqësorë</li> </ul>	Janar 19 deri dhjetor 20	Komisioni i Përhershëm i Planifikimit Strategjik, Buxhetit dhe Administrimit dhe Këshillat e Gjykatave	Në proces	
<b>Afati / Statusi</b>							
<b>Detaje Përkatëse për Gjykatën e Lartë</b>		<p>Gjykata e Lartë është e mirëorganizuar, efikase dhe e efektshme me administrim të përmirësuar manual dhe elektronik të çështjeve, plane në zbatim për mbledhje të rregullta që sigurojnë që komunikimi i brendshëm efikas dhe proceset e brendshme të gjykatës të përmirësohen përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Procese të Reja të Punës të miratuara dhe në zbatim</li> <li>Ndryshimeve të ICNIS-it që po hartohen, testohen dhe vihen në zbatim</li> <li>Plani i Komunikimit të Brendshëm miratohet dhe ndahet</li> <li>Miratim i Rregullave të Brendshme Standarde të KLGJ-së</li> <li>Hartohen dhe miratohen rregullat e brendshme më të detajuara për Gjykatën e Lartë</li> </ul>	Analizim i të gjitha proceseve të punës së gjykatave, përgatitjes së hartave përkatëse “siç janë” dhe hartat verifikohen me personelin e gjykatave nga të gjitha drejtoritë e gjykatës		<b>Përfunduar 85% - pjesa e mbetur përfundohet brenda gushtit 2020</b>		
			Hartohen ndryshimet e proceseve aktuale të punës dhe përgatiten hartat “si do jenë” që janë në përputhje me kodet e rishikuara të procedurës, ligjet e reformës dhe praktikat më të mira për arritjen e veprimtarive më të efektshme të brendshme të gjykatës		<b>Përfunduar 70% - pjesa e mbetur përfundohet brenda gushtit 2020</b>		
			Verifikohen dhe miratohen hartat “si do jenë” në Këshillin e Gjykatës së Lartë dhe në Komisionin e Posaçëm të KLGJ-së / Mbledhjen Plenare të KLGJ-së, sipas nevojës		<b>Shtator 2020</b>		
			Përcaktohen përmirësimet për ICNIS-in dhe punohet me donatorët ndërkombëtarë për zbatimin e tyre		<b>Jo më vonë se fundi i muajit gusht 2020</b>		
			Hartohet plani i brendshëm i komunikimit që siguron pjesëmarrje aktive të të gjithë personelit të gjykatës dhe përqendrohet në synimet e performancës në mbarë gjykatën, veçanërisht punën për zbatimin e veprimtarive për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura		<b>Gusht 2020</b>		
			KLGJ miraton Rregullat e Brendshme Standarde të Gjykatës së Lartë		<b>Shtator 2020</b>		
Gjykata e Lartë harton dhe miraton rregulla më të detajuara për funksionimin e gjykatës, që sigurojnë që të gjitha rekomandimet që lidhen me përmirësimet e proceseve të punës dhe veprimtaritë e tjera të brendshme të përshkruhen dhe përcaktohen me qëllim sigurimin e veprimtarisë efikase dhe të efektshme.		<b>Tetor 2020</b>					
Gjykata e Lartë dhe KLGJ propozojnë ndryshime ligjore lidhur me efektshmërinë e gjykatës të cilat mund të përfshijnë përbërjen e trupave gjyqësore dhe kompetencat e kolegeve.		<b>Nëntor – Dhjetor 2020</b>					

**Synimet dhe Objektivat për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura**

	Qëllimi & Objektivat	Treguesi i Suksesit	Veprimtaritë Kyçe (Si)	Afati	Drejtuesi (Kush)	Statusi	Komente
PLANI STRATEGJIK I GJYQËSORIT	1.5 Ulja e numrit të çështjeve të prapambetura në të gjitha shkallët e gjyqësorit përmes miratimit të një plani veprimi	Treguesi i Mbështetjes së Buxhetit të SNSD-së - ulja e numrit të çështjeve në Gjykatën e Lartë për vitin 2019 është 200 më pak se baza fillestare e vitit 2017 dhe ulja në vitin 2020 në është 500 çështje më pak se baza fillestare e vitit 2019	➤ Angazhimi me partnerët ndërkombëtarë (donatorët) për të trajtuar çështjet e prapambetura në Gjykatën e Lartë dhe hartimi i një plani veprimi brenda tre muajsh nga miratimi i këtij plani strategjik	Qershor 19 deri dhjetor 20	Komisioni Ad Hoc i KLGJ & Këshilli i Gjykatës së Lartë	Në proces	Pajtuar me Planin e Veprimit të SNSD-së shkurt 2019, Nën Objektivin 1/b, seksioni 3
<b>Detaje Përkatëse për Gjykatën e Lartë</b>	<b>Treguesit e Suksesit shtator - dhjetor 2020</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dymbëdhjetë Nëpunës për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura (NUNÇP) janë përzgjedhur, trajnuar dhe punojnë vazhdimisht me çështjet e prapambetura</li> <li>Të gjitha çështjet e prapambetura klasifikohen në 3 kategori dhe nënkategori kryesore çështjesh, të ndara në kategori me çështje të thjeshta, çështje të papranueshme, së bashku me kategorizime të tjera.</li> <li>5000 (5000 - 8000) çështje përgatiten nga NUNÇP-të për këshilltarët ligjorë; këshilltarët ligjorë hartojnë opinionet ligjore dhe i dërgojnë çështjet e gatshme për gjykim në Dhomat e Këshillimit për zgjidhje <b>(100 -120 çështje për NUNÇP në muaj)</b></li> <li>Zgjidhen 5000 çështje të prapambetura <b>(334 çështje për relator në muaj me 3 gjyqtarë ose 250 çështje për relator në muaj me 4 gjyqtarë)</b></li> </ul>	MM-ja e nënshkruar midis KLGJ dhe JFA për uljen e çështjeve të prapambetura, komunikimin e brendshëm dhe fillimin e punës më efikase manuale dhe elektronike dhe proceseve të menaxhimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë			<b>Përfunduar</b>	
			KLJG, Gjykata e Lartë dhe JFA kryejnë procesin e përzgjedhjes; punësohen 12 kandidatë NUNÇP			<b>Përfunduar</b>	
			Hierarkia në procesin e punës për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë është përcaktuar			<b>Përfunduar</b>	
			Merret vendimi për caktimin e këshilltarëve ligjorë që do të jenë mentorë dhe do të monitorojnë punën e NUNÇP-ve			<b>Përfunduar</b>	
			Ekipi i Koordinimit të Brendshëm në Gjykatën e Lartë caktohet për monitorimin e punës për çështjet e prapambetura; i raporton KLGJ-së dhe vlerëson performancën e secilit NUNÇP			<b>Përfunduar</b>	
			Këshilltarët ligjorë të GJL-së trajnojnë NUNÇP-të lidhur me aspektet ligjore të punës së tyre, JFA trajnon NUNÇP-të lidhur me proceset e punës në Gjykatë			<b>Korrik 2020</b>	
			Përfundohen plani i veprimit dhe standardet e performancës për secilën kategori/nënkategori çështjesh			<b>Gusht 2020</b>	
			NUNÇP-të, së bashku me këshilltarët ligjorë krijojnë dhe përmirësojnë vazhdimisht formate tip për lista të ndryshme kontrolli dhe masa të tjera efikasiteti për punë më të shpejtë dhe më të efektshme;			<b>Nis jo më vonë se shtator 2020</b>	
			Çështjet e prapambetura kategorizohen vazhdimisht nga NUNÇP-të dhe i kalohen këshilltarëve ligjorë për hartimin e opinionit ligjor			<b>Nis jo më vonë se shtator 2020</b>	
			Kolegji/kolegjet e gjyqtarëve rrisin vazhdimisht numrin e gjytimeve dhe mbylljen e çështjeve			<b>Vazhdimisht</b>	

**Synimet dhe Objektivat për Rritjen e Transparencës dhe e Besimit të Publikut**

	Qëllimi & Objektivat	Treguesi i Suksesit	Veprimtaritë Kyçe (Si)	Afati	Drejtuesi (Kush)	Statusi	Komente
PLANI STRATEGJIK I GJYQËSORIT	<b>5.4 Rritja e transparencës në të gjithë sistemin gjyqësor përmes publikimit në kohë të vendimeve të gjykatave në faqen e internetit të KLGJ-së</b>	Miratim dhe zbatim i rregullave për publikimin; numri i vendimeve të gjykatave të publikuara brenda afatit të caktuar	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Përcaktimi i standardeve të publikimit për të gjitha gjykatat dhe llojet e çështjeve, përfshirë kërkesat e ndërmjetme, ndërkohë që krijohet Portali i Gjyqësorit</li> <li>➤ Koordinim me MD-në për transferimin e aseteve të TI-së, përfshirë faqet e internetit të gjykatave në <a href="http://www.gjykata.al">www.gjykata.al</a></li> <li>➤ Mbledhja e të dhënave përkatëse dhe të vlefshme, që janë të rëndësishme për raportimin e veprimtarisë së gjykatave</li> </ul>	Qershor 2019 deri dhjetor 2020	Anëtari i KLGJ-së i caktuar për marrëdhëniet me publikun i mbështetur nga administrata e KLGJ-së	Në proces	
				<b>Afati / Statusi</b>			
<b>Detaje përkatëse për Gjykatën e Lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritje e transparencës së punës së Gjykatës përmes faqes aktuale dhe të ardhshme të internetit</li> <li>• Krijohen profilet në mediat sociale</li> <li>• Gjykata komunikon rregullisht me publikun dhe përdoruesit e gjykatës</li> <li>• Besimi i publikut dhe përdoruesve të gjykatës përmirësohet përmes uljes së numrit të çështjeve të prapambetura</li> </ul>	Hartimi i strategjisë së pranisë në publik për zbatimin e një fushate ndërgjegjësimi për rritjen e besimit	<b>Shtator 2020</b>				
		Zhvillohen takime shkëmbimi me palët e interesit dhe bashkëpunëtorët	<b>Tetor - Dhjetor 2020</b>				
		Sigurimi i trajnimit të nevojshëm për Nëpunësit e Gjykatës për Median dhe Marrëdhëniet me Publikun (NMMP)	<b>Tetor / Nëntor 2020</b>				
		Krijimi i profileve në mediat sociale dhe sigurimi i trajnimit të përshtatshëm për përdorimin e tyre për NMMP-në	<b>Tetor / Nëntor 2020</b>				
		Informimi i vazhdueshëm i publikut për ecurinë mujore të uljes së numrit të çështjeve të prapambetura dhe veprimtarive të tjera që lidhen me efikasitetin e Gjykatës	<b>Vazhdimisht</b>				
		Përgatitja e një materiali filmik për theksimin e veprimtarive dhe progresit të Gjykatës si rezultat i zbatimit të MM-së	<b>Jo më vonë se mars 2021</b>				

## **Falënderime:**

Ky Udhërrëfyes u bë i mundur falë punës së përkushtuar të personave dhe grupeve të mëposhtme:

### **Grupi i Punës për Udhërrëfyesin për Funkcionalitetin e Gjykatës së Lartë:**

Kryetar                    Maksim Qoku  
Anëtarë                    Medi Bici  
                                  Marcela Shehu  
                                  Brunilda Kadi  
Këshilltare ligjore    Elisa Stamo

### **Kryetar dhe Anëtarë të Komisioneve të Përhershme dhe Ad-Hoc:**

Naureda Llagami  
Brikena Ukperaj  
Ilir Toska  
Alban Toro

### **Gjykata e Lartë:**

Kryetari në Detyrë Sokol Sadushi  
Kancelari në Detyrë Agim Gogu

### **Stafi administrativ mbështetës i KLGJ-së:**

Luljeta Laze  
Ejona Isufaj



**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR &  
GJYKATA E LARTË E SHQIPËRISË**

**[WWW.KLGJ.AL](http://WWW.KLGJ.AL) &  
[GJYKATAELARTE.GOV.AL](http://GJYKATAELARTE.GOV.AL)**